

# KËRKESË PËR RISHQYRTIM

*Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Për: **K.K. SKENDERAJ**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

<b>Nr i Prokurimit</b>	<b>643-23-13658-1-3-6</b>
<b>Nr i brendshëm</b>	

Sa i përket tenderit për

## 1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	<b>MEDPLUS SH.P.K.</b>
NUI	<b>811867441</b>
Adresa	<b>Rr. Pranvera e Lirisë, p.n, Lebanë</b>
Vendi	<b>Prishtinë</b>
Kodi postar	<b>10000</b>
Numri Telefonit	<b>044640420</b>
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	<b>Jeton Prenaj</b>
Adresa elektronike	<b>medplusks@gmail.com</b>
Data e parashtrimit të kërkesës	<b>20.02.2024</b>

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtrojë kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

Emri i avokatit  
Adresa e plotë  
Numri i Telefonit  
Numri i faks-i  
Adresa elektronike t

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

**Njoftimi për Kontratë me dt. 06.12.2023**

**Afati i fundit për dorëzimin e ofertave me dt. 12.12.2024 ora 14:00**

**Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 04.01.2024**

**Njoftimi mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit: 15.02.2024**

#### **4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet**

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

Po

Jo

#### **5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet**

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

Po

Jo

#### **6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Neni 1 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 26 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 60 i LPP-së

Neni 62 i LPP-së

Neni 21 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik

Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik

Neni 43 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik

## 7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.*

Me dt. 06.12.2023 është publikuar njoftimi për kontratë për tenderin me titull “Furnizim me barna dhe material shpenzues - QKMF Skenderaj”.

Nga procesverbali i hapjes së ofertave i dt.12.12.2023 shihet që vetëm kompania jonë kemi ofertuar në këtë tender.

Me dt.22.12.2023 na janë kërkuar dokumentet e provueshmërisë- vërtetimi i ATK dhe i gjykatës dhe ne i kemi dorëzuar ato tek autoriteti kontraktues.

Me dt.04.01.2024 përmes platformës elektronike e-prokurimi kemi pranuar njoftimin mbi vendimin (B 58) dhe Letrën standarde për tenderues te suksesshëm. Pra jemi rekomanduar për kontratë.

Më pastaj kishte kaluar afati për parashtrim të kërkesave për rishqyrtim dhe të ankesave dhe ishim në pritje të ftesës për nënshkrim të kontratës, ku çuditërisht me dt.15.02.2024 përmes platformës elektronike e-prokurimi kemi pranuar njoftimin për anulim të aktivitetit të prokurimit me arsyetimin se:

**Një dispozitë në Ligjin e Prokurimit Publik kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit;**

Ndërsa tek informacionet shtesë është shënuar si në vijim:

*”Komisioni i Vlerësimit pas shqyrtimit të dokumentacionit përfundimtare ka konstatuar se OE MEDPLUS SH.P.K me çmimin ofertues prej 9,989.90 dhe çmimin pas korigjimit nga ana e komisionit vlersues prej 10,014.68 euro, e cila kalon nga Procedurë e Kuotimit të Çmimit - Vlerë e ulët, në procedurë me vlerë të mesme”.*

Arsyeja e anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit është e pa qartë dhe e pa bazuar. Realisht kur thuhet një dispozitë e LPP-së kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit, duhet të specifikohet cila dispozitë është ajo, mirëpo autoriteti kontraktues nuk ka specifikuar ndonjë dispozitë të tillë, prandaj arsyeja e anulimit është e pabazuar.

Realisht neve na është dërguar letra standarde për korigjim të gabimeve aritmetike me dt.20.12.2023, mirëpo në atë letër nuk është sqaruar se ku është bërë ai gabim aritmetik, ndërsa ne me dt.22.12.2023 kemi shpreh pajtimin tonë me çfarëdo gabimi që ka mund të ndodh në përllogaritje.

Nëse do të kishte ndonjë problem ligjor përllogaritja e çmimeve dhe të kalonte vlera mbi 10 mijë euro është dashur të veprohet menjëherë dhe të anulohet aktiviteti i prokurimit, e

jo njëherë të shpallemi fitues e më pastaj të rikthehet kjo çështje në fazën e vlerësimit të ofertave dhe të zhvendoset arsyeja e anulimit tek komisioni vlerësues.

Gjithashtu duhet cekur fakti se edhe nese ka gabim aritmetik, vet e keni cekur se është nen 2% dhe ky fakt nuk ndikon ne proces te mëtutjeshëm dhe në përgjegjshmërinë e ofertës.

Ne i kemi bërë të gjitha përgatitjet për nënshkrim të kontratës dhe për implementim/furnizim prandaj ky veprim i AK-së na shkakton dëme të mëdha financiare.

Arsyeja e anulimit është e pabazuar, pasi që edhe nëse do të kalonte vlerën 10 mijë euro oferta jonë, nuk ka asnjë problem dhe nuk parashihet askund në LPP që të anulohet një aktivitet i prokurimit me një arsyetim të tillë, prandaj kërkojmë që të zbatohen dispozitat e LPP-së dhe të procedohet me nënshkrim të kontratës.

Edhe po të kishte arsye të eliminimit fillimisht duhet të ngritet në sistem formulari B58 e jo njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, këtë e parasheh edhe neni 24 I rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim publik:

**21.4 pika f.** Autoriteti kontraktues duhet të publikoj Njoftimin mbi Vendimin e AK (B58) edhe në rast se vendimi ka të bëjë me anulimin e aktivitetit të prokurimit në tërësi ose një/disa Lot-e në kuadër të aktivitetit të prokurimit.

Në rastin konkret është dashur të publikohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe më pastaj të nënshkruhet kontratë.

Në këtë rast janë përmbushur të gjitha kushtet për nënshkrim të kontratës prandaj duhet zbatuar neni 26 i LPP-së.

Arsyeja e anulimit nuk parashihet në nenin 62 të LPP-së e as në nenin 43.5 të RRPP Nr.001/2022, prandaj ky anulim është jo i bazuar në dispozita të legjislacionit primar dhe sekondar.

Duke pasur parasysh të gjitha arsyet ligjore që u përmendën më lartë, kërkojmë që të merrni:

## **VENDIM**

**APROVOHET**, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE **MEDPLUS SH.P.K.**,

**ANULOHET** njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe të vazhdohet me nënshkrim të kontratës.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

## 8. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 5,000.00 euro**

## 9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) *një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) *një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*